LIGJ
Nr.9803, datë 13.9.2007

PËR FALJEN E KAMATËVONESAVE TË FATURAVE TË PAPAGUARA TË KONSUMIT TË UJIT, QË KONSUMATORËT FAMILJARË DHE JOFAMILJARË KANË NDAJ NDËRMARRJEVE DHE SHOQËRIVE, ME KAPITAL TËRËSISHT SHTETËROR, TË UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Konsumatorëve familjarë dhe jofamiljarë, të cilët deri më datë 31.12.2007 shlyejnë kundrejt ndërmarrjeve dhe shoqërive, me kapital tërësisht shtetëror, të ujësjellës-kanalizimeve të gjitha detyrimet e papaguara të faturave të ujit, u falen kamatëvonesat e krijuara deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5463, datë 19.9.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi